

Takim pune

“Puna përgatitore e INSTAT-it për zbatimin e standardeve të reja ndërkombëtare lidhur me statistikat e punë-zënies, punësimit dhe nën-përdorimit të punës”

E enjte, 24 Nëntor 2016

Hotel Tirana International, Tiranë

**“Statistikat e tregut të punës në Shqipëri –
Gjendja aktuale”**

Elda Muça

Eksperte për statistikat e punës, INSTAT

Burimet e të dhënave

- Të dhënat administrative (bazuar në Programin Statistikor Kombëtar dhe të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me qëllim përlogaritjen e pagave).
- Anketa e Tremujore e Forcave të Punës.
- Anketa e Kostos së Punës.
- Rregjistrimet e Popullsisë dhe Banesave (më i fundit në vitin 2011)

Historia e zhvillimit të Anketës së Forcave të Punës në Shqipëri

Anketa e Forcave të Punës është burimi kryesor për statistikat e tregut të punës

Anketa e parë e Forcave të Punës në Shqipëri u krye në vitin 2007.

2007-2011 AFP është kryer në baza vjetore

LFS 2007 Prill-Maj

LFS 2008-2011 Shtator - Tetor

2012 e në vijmim AFP është e vazhdueshme (tremujore)

Tremujorët kalendarikë – kërkesë e BE sipas rregullores për AFP

Historia e zhvillimit të AFP

Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve që jetojnë në adresa private në Shqipëri.

Qëllimi i anketës është të sigurojë informacion mbi tregun e punës në Shqipëri i cili më pas përdoret për të zhvilluar, menaxhuar, vlerësuar dhe raportuar mbi politikat e tregut të punës.

AFP menaxhohet nga Drejtoria e Statistikave Sociale e INSTAT-it dhe mbështetet nga zyrat rajonale statistikore në 12 prefektura, si dhe zyrat statistikore në rrethe.

Në vitin 2011 - Asistenti Personal Dixhital (APD) për grumbullimin e të dhënave, në vend të pyetësorëve letër.

Në vitin 2013 u kalua në metodën CAPI- anketa kryhet me intervistim të drejtpërdrejtë duke përdorur kompjuterin (laptop).

Baza ligjore e anketës

- a. Metodologjia e AFP-së bazohet në "Rezolutën që lidhet me statistikat e popullsisë që është ekonomikisht aktive, punësimit, papunësisë dhe nën-punësimit", miratuar nga ICLS e 13^{të}, 1982.
- b. Rregullorja kryesore për zbatimin e Anketës së Forcave të Punës në Shtetet Anëtare të Komunitetit Evropian është Rregullorja e Këshillit Evropian Nr. 577/98 e datës 9 mars 1998 (e ndryshuar), mbi organizimin e anketës të forcave të punës në Komunitet (me zgjedhje probabilitare).
- c. Rregulloret pasuese të KE
- d. Programi i Statistikave Zyrtare

Rregullorja e KE, Nr 577/98 e datës 9 Mars 1998

Neni 4: Karakteristikat e Anketës

a) Të dhëna bazë mbi pjesëtarët e familjes

- numri rendor në familje
- gjinia
- viti i lindjes
- data e lindjes lidhur me fundin e periudhës së referencës
- gjendja civile
- lidhja me personin e referencës
- numri rendor i bashkëshort-it/es ose partner-it/es bashkëjetues/e
- numri rendor i babait
- numri rendor i nënës
- shtetësia
- vendi i lindjes
- mënyra e marrjes pjesë në anketë (personi përgjigjet vetë apo një pjesëtar i familjes përgjigjet në emër të tij)

b) Statusi i punësimit gjatë javës së referencës

- statusi i punësimit
- arsyeja pse personi nuk ka punuar megjithëse e ka patur një punë
- kërkimi për punë për personat që nuk kanë punë
- lloji i punës së kërkuar (i/e vetëpunësuar ose i punësuar me pagë)
- metodat e kërkimit për punë
- gatishmëria për të filluar punë

c) Karakteristikat e punës kryesore

- statusi në punësim
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale
- profesioni
- përgjegjësitë për të mbikëqyrur apo drejtuar aktivitetet e të punësuarve të tjerë
- numri i personave që punojnë në njësinë lokale
- shteti ku gjendet vendi i punës
- rajoni ku gjendet vendi i punës
- viti dhe muaji kur personi ka filluar të punojë në punën aktuale
- angazhimi i zyrës publike të punësimit për gjetjen e punës aktuale
- vazhdueshmëria e punës (dhe arsytet)
- kohëzgjatja e kontratës së punës së përkohshme
- dallimi i punës me kohë të plotë / të pjesshme (dhe arsytet)
- kontrata me një agjenci punësimi të përkohshme
- puna në shtëpi

d) Orari i punës

- numri i orëve të zakonshme të punës në javë
- numri i orëve aktuale (gjatë javës së referencës) të punës
- arsyeja kryesore pse orët aktuale të punës të personit ndryshojnë nga orët e zakonshme
- numri i orëve të punës jashtë orarit gjatë javës së referencës
- kërkimi për një punë tjetër dhe arsyet përse kërkon punë tjetër

e) Puna e dytë

- pasja e më shumë sesa një punë
- statusi në punësim
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale
- numri i orëve aktuale (gjatë javës së referencës) të punës

f) Orët totale të punës & Modele pune

- numri i orëve që personi do të dëshironte të punonte zakonisht në javë
- personi punon me turne
- personi punon mbrëmjeve
- personi punon natën
- personi punon të shtunave
- personi punon të dielave

g) Eksperienca e mëparshme e punës e personave jo në punësim

- ekzistenca e eksperiencës së mëparshme të punës
- viti dhe muaji në të cilin personi ka punuar në punën e tij të fundit
- arsyeja kryesore pse personi ka pushuar së punuari në punën ose biznesin e tij/saj të fundit
- statusi në punësim në punën e fundit
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale në të cilën personi ka punuar herën e fundit
- profesioni në punën e tij/saj të fundit

h) Kërkimi për punë

- lloji i punës së kërkuar (me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme)
- kohëzgjatja e kërimit për punë
- situata e personit menjëherë para se të fillonte të kërkonte punë
- personi është i regjistruar në zyrën publike të punës dhe merr ose jo pagesë papunësie
- gatishmëria për të punuar e personave që nuk po kërkojnë punë
- arsyet pse personi nuk po kërkon punë
- mungesa e shërbimeve të kujdesit

i) Arsimimi dhe trainimi

- ndjekja e shkollës ose trajnimeve gjatë katër javëve të fundit
- niveli i shkollimit ose trajnimit
- qëllimin e shkollimit ose të trajnimit
- kohëzgjatjen totale
- numrin total të orëve të shkollimit ose të trajnimit gjatë katër javëve të fundit
- nivelin më të lartë të shkollimit apo trajnimit të përfunduar me sukses
- vitin e përfundimit të nivelit më të lartë të shkollimit apo trajnimit
- kryerjen e trajnimeve apo kualifikimeve profesionale (pavarësisht nga kohëzgjatja)

j) Situata një vit më parë

- statusi kryesor i punësimit
- statusi në punësim
- aktiviteti ekonomik i njësisë lokale në të cilën punonte personi

Metodologjia e AFP


- AFP është përcaktuar që të jetë përfaqësuese për të gjithë popullsinë e Shqipërisë.
- Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure me dy hapa, ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit, dhe në hapin e dytë, brenda secilës prej këtyre zonave gjeografike zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks familjesh.
- Për periudhën 2012–2014 madhësia e zgjedhjes ishte 5.040 njësi ekonomike familjare për tremujor.
- Përgjatë vitit 2015, pati një rritje graduale të numrit të familjeve të zgjedhura për anketim, deri në tremujorin e parë të vitit 2016 ku madhësia e zgjedhjes arriti në 7.900 njësi ekonomike familjare për tremujor, masë që mbetet konstante në vijimësi.

	PSU me 8 fam	PSU me 10 fam	PSU gjithsej	HH-s
Tr IV 2014	630	0	630	5040
Tr I 2015	504	158	662	5612
Tr II 2015	378	316	694	6184
Tr III 2015	252	474	726	6756
Tr IV 2015	126	632	758	7328
Tr I 2016	0	790	790	7900

Metodologjia e AFP

- Pra, aktualisht, zgjedhja është e shpërndarë në 790 njësi primare statistikore, ku në secilën prej tyre janë zgjedhur 10 njësi ekonomike familjare .
- Për ATP e vazhdueshme përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen saktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë.

Përkufizimi për statusin e punësimit



Publikimi i rezultateve

Publikimi i rezultateve të AFP tremujore bëhet 8 javë pas përfundimit të periudhës së vrojtimit të tremujorit përkatës dhe rezultatet vjetore janë mesatare e tremujorëve të vitit. Që prej tremujorit të parë të vitit 2016, disa tregues kryesore publikohen jo vetëm në nivel vendi, por edhe në nivel qarku.

Produkti	Periodiciteti	Niveli i përfaqësimit
Deklaratë për shtyp	Tremujor	NUTS I, NUTS III
Tregu i Punës në Shqipëri Tregu i Punës, 2015 - INSTAT	Vjetor	NUTS I
Të dhënat mikro Të Dhëna Mikro - INSTAT	Vjetor	NUTS I

Aktivitete statistikore të planifikuara në kuadër të Programit të ri Statistikor (2017-2021)

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative mbi punësimin dhe papunësinë.
- Anketa tremujore e Forcave të Punës.
- Anketa e Kostove të Punës (2016).
- Përpunimi i treguesve administrativë mbi pagën mesatare mujore për një të punësuar me pagë.
- Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna (2019).
- Mbledhja e treguesve ekzistues të mbrojtjes sociale.
- Mbledhja e të dhënave të mbrojtjes sociale në përputhje me Sistemin Evropian të Statistikave të Integruara për Mbrojtjen Sociale (ESSPROS)

Rishtë që do të sjellë ky program:

- Gamë më e gjerë treguesish statistikore të tregut të punës.
- Metodologji e harmonizuar me standardet e Eurostat-it për strukturën e të ardhurave nga puna.
- Hendeku gjinor në paga i llogaritur sipas metodologjisë së Eurostat-it bazuar në të dhënat e Anketës së Strukturës së të Ardhurave.
- Përfitimi i Statistikave të Mbrojtjes Sociale të krahasueshme në nivel Evropian nëpërmjet hartimit të tyre në përputhje me ESSPROS (Sistemi Evropian i Statistikave të Integruara për Mbrojtjen Sociale).

Faleminderit!